



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT – RAPORT

PËR

AUDITIMIN ME BAZË SISTEMI

MBI

**“VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË, RREGULLSHMËRISË DHE
PERFORMANCËS SË REALIZUAR NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE
PUBLIKE, BASHKIA ROSKOVEC”.**

Periudha e audituar: 01.01.2017 deri 31.12.2019

Grupi i auditëve : Gilda ZYKA

Gëzim HABILI

Eltona ÇEPELE

Roskovec, Korrik, 2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PROJEKT RAPORT

MBI ANGAZHIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE PRANË BASHKISË ROSKOVEC.

Mbahet sot më datë 14.07.2020 nga grupi i punës së audituesve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm pranë Bashkisë Roskovec, mbi angazhimin e auditimit për ***“Vlerësimin e veprimtarisë në zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe performancës të realizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Roskovec”***.

Angazhimi i auditimit në këtë subjekt u mbështet në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, si dhe programin e auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë.

I. Përmbledhje ekzekutive.

Sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetare e Bashkisë me shkresën nr. 1005/2, prot. datë 20.02.2020, ***“Mision angazhim auditimi për vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Roskovec”***, grupi i auditimit i përbërë nga Përgjegjës grupi zj. Gilda Zyka, auditues zj. Eltona Çepele dhe z. Gëzim Habili, realizoi misionin e angazhimit të auditimit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Roskovec.

Qëllimi i këtij mision auditimi është që të ndihmojë Drejtorinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Roskovec, në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm, nxjerrja e konkluzioneve dhe dhënia e sigurisë objektive mbi dokumentimin e aktivitetit të të gjithë Sektorëve të saj, si dhe dhënia e rekomandimeve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për përmirësimin e punës në vazhdimësi, etj.

II. Hyrje

Gjatë kryerjes së misionit të auditimit, nga grupi i auditimit është synuar një vlerësim në tërësi i sistemit në përputhje me Udhëzimet dhe metodikat e miratuara, me qëllim që sistemet e menaxhimit financiar e të kontrollit si dhe performanca e njësisë së audituar, të jenë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.

Auditimi është realizuar nga data 24.02.2020 deri më 30.06.2020, gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) ditë pune, për periudhën e audituar nga ***01.01.2017 deri 31.12.2019***. Kjo zgjatje e afatit të auditimit u kondicionua nga situata e rënduar e pandemisë globale të shkaktuar nga COVID 19, por

edhe nga prania e grupit të punës së KLSH-së, që do të auditonte Institucionin e Bashkisë Roskovec për periudhën nga 01.01.2017 deri 31.03.2020.

Janë diskutuar në Takimin fillestar (të Hapur) me D/Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Arben Dukaj, si dhe me punonjës të tjerë të kësaj Drejtorie, objektivat, formatet, metodat e auditimit, linjat e komunikimit, si dhe afatet për raportime.

Gjatë këtij misioni auditimi janë realizuar të gjitha pikat e programit të auditimit sipas tematikës së miratuar. Pasi ka përfunduar edhe puna në terren, janë diskutuar gjetjet (**konstatimet**) e këtij misioni auditimi me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Roskovec dhe është rënë dakort për çështjet e dala.

III. Metoda e Auditimit.

Gjatë realizimit të misionit të auditimit, grupi i punës i auditimit ka punuar në përputhje me udhëzimet dhe metodikat e miratuara. Është mbuluar me auditim periudha nga **01.01.2017 deri 31.12.2019**. Audituesit janë njohur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe kanë bërë një vlerësim në tërësi të sistemit. Komunikimi i qartë, konçiz dhe në kohë me stafin e njësisë së audituar ka ndihmuar në efijencën dhe efektivitetin e procesit të angazhimit të auditimit.

Auditimi u krye në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Urdhërit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe në zbatim të planit të auditimeve për vitin 20120, të miratuar nga Kryetare e Bashkisë me shkresën nr. 6109/1, datë 24.10.2019.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

1. Auditimi i strukturës organizative. Respektimi i organikave të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Nga auditimi rezultoi se :

Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Roskovec, e ushtron aktivitetin e saj në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Urdhërit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, azhurnuar me Ligjin nr. 73/2015, “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 28//2017, “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit””, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 175/2011, datë 25.02.2011 “Për planin kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Ligjit nr. 8378, “Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 8308,, “Për Transportet Rrugore” të ndryshuar, Ligjit nr. 8450, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, Ligjit nr. 9220/2004, datë 13.05.2015 “ Për administrimin e shërbimit të varrimit”, VKM nr. 629, datë.15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, VKM nr. 671, datë 29.07.2015 ”Për miratimin e Rregullores së planifikimit të territorit”, VKM nr. 319/2018 ”Për llogaritjen e kostos për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, VKM nr. 915/2015 ”Për transferimin në pronësi të shërbimit të varrimit nga Këshillat e Qarqeve tek Bashkitë”, VKM nr. 712/2014 ”Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në Republikën

e Shqipërisë”, VKM nr. 970/2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve të dhënien e Licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, të ndryshuar, etj.

Nga auditimi u konstatua se është hartuar Rregullorja e Brendshme (e përvitësuar) e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në të cilën është shprehur **baza ligjore** ku mbështetet puna e kësaj Drejtorie, struktura organizative si dhe funksionimi i saj. Për sa i përket kryerjes së detyrave, çdo nëpunës apo specialist i Sektorëve të këtij subjekti, ka të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë për të cilat përgjigjet para niveleve më të larta.

Drejtoria e Shërbimeve Publike aktualisht ka në përbërje të vet 2 (dy) Sektorë, Sektorin e Zbatueshmërisë së Investimeve dhe Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Emergjencave Civile.

Misioni kryesor i kësaj Drejtorie është :

- Menaxhimi, dhe mbikëqyrja në lidhje me punën dhe aktivitetin e sektorëve përbërës të saj ;
- Përgatitja e analizave, raporteve dhe bërja e propozimeve për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e punës në Bashki ;
- Organizimi, vëzhgimi dhe bashkërendimi punës, afatet, detyrat e ngarkuara dhe bashkëpunimi me drejtoritë e tjera ;
- Drejtimi dhe bashkërendimi i punës me vartësit dhe me strukturat e tjera për hartimin e politikave dhe strategjive për përmirësimin e shërbimeve që ofrohet nga kjo drejtori ;
- Bashkëpunimi me strukturat e tjera në Bashkinë Roskovec dhe me Njësitë Administrative në varësi të saj ;
- Realizimi i analizave periodike për veprimtarinë e drejtorisë dhe të informoj periodikisht Kryetarin e Bashkisë për veprimtarin e Drejtorisë, ecurinë e zbatimit të detyrave të ngarkuara ;
- Delegimi i detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje, ndjek dhe kontrollon punën që bëhet nga sektorët vartës, për përcaktimin dhe dhënien e zgjidhjeve ligjore, teknike dhe administrative në afatet e caktuara, etj.

Në strukturë, Kryetare e Bashkisë për vitin 2017, ka miratuar Vendimin “Për Strukturën organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum” me nr. 12, datë 10.01.2017, ku për Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka miratuar 34 punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie, 1 (një) Përgjegjës Sektori (mbulon Sektorin e Investimeve dhe mirëmbajtje rruge) , dhe 26 (njëzetë e gjashtë) punonjës (në këtë Sektor), si dhe (një) Përgjegjës Sektori (mbulon Sektorin e Dekorit dhe Ndricimit) dhe 5 (pesë) punonjës (në këtë Sektor).

Ndërsa për vitin 2018, në strukturë, Kryetare e Bashkisë ka miratuar Vendimin “Për Strukturën organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum” me nr. 15, datë 12.01.2018, ku për Drejtorinë e Investimeve, Mirëmbajtje Rruge, Dekorit dhe Ndricimit ka miratuar 43 (dyzetë e tre) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie, 1 (një) Përgjegjës Sektori (mbulon Sektorin e Investimeve dhe mirëmbajtje rruge) dhe 24 (njëzetë e katër) punonjës (në këtë Sektor), 1 (një) Përgjegjës Sektori (mbulon Sektorin e Dekorit dhe Ndricimit) dhe 5 (pesë) punonjës (në këtë Sektor), si dhe 1 (një) Përgjegjës Sektori (mbulon Sektorin e Mekanizatorëve) dhe 10 (dhjetë) punonjës (në këtë Sektor).

Po kështu, për vitin 2019, në strukturë, Kryetare e Bashkisë ka miratuar Vendimin “Për Strukturën organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum” me nr. 473, datë 26.12.2018, ku për Drejtorinë e Shërbimeve Publike ka miratuar 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës nga të cilët, 1 (një) Drejtor Drejtorie, 1 (një) Përgjegjës

Sektorin (mbulon Sektorin e Zbatueshmërisë së Investimeve) dhe 2 (dy) punonjës specialistë (në këtë Sektor), 1 (një) Përgjegjës Sektorin (mbulon Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Emergjencave Civile) dhe 12 (dymbëdhjetë) punonjës (në këtë Sektor).

Për periudhën objekt auditimi, konstatohet se kjo strukturë ka operuar me organikë të plotësuar.

2. Sistemi i evidentimit të realizimit të detyrave nga Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve, në menaxhimin me cilësi dhe sipas standarteve të kërkuara të projekteve dhe investimeve.

A. Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve

Misioni dhe detyra kryesore e këtij Sektorit është :

- Menaxhimi me cilësi, sipas standarteve të kërkuara dhe në afatet e përcaktuara të projekteve dhe investimeve duke siguruar përmirësimin e cilësisë nëpërmjet zbatimit dhe realizimit të tyre.

- Po kështu, sigurimi i realizimit të investimeve publike në kohë dhe në cilësi për objektet e infrastrukturës si dhe realizimin e tyre në afatet e përcaktuara, konform KTP dhe KTZ të projektimit dhe zbatimit sipas projekteve të miratuara, nëpërmjet monitorimit rigoroz dhe të vazhdueshëm.

- Realizimi i investimeve në kohë dhe me cilësi në objektet e infrastrukturës së ndërtesave urbane në qytetin e Roskovecit duke siguruar përmisimin e infrastrukturës së tyre.

Të dhëna më të plota për realizimin e investimeve përgjatë periudhës objekt auditimi, i gjejmë në pasqyrat e mëposhtëme. Kështu, për vitin 2017, do të kemi :

Kontrata dhe investimet për 2017

Nr.	Emërtimi i kontratës	Operatori Ekonomik fitues	Vlera e kontratës	Afati i mbarimit	Mbikqyrës i punimeve
1	Ndërtimi i qendrës së Fshatit Jagodinë	“Aluera”	2,884,704	1 muaj	“Novatech Studio”
2	Sistemimi i qëndresës së Fshatit Vidhishtë	“Aluera”	11,638,776	2 muaj	“Novatech Studio”
3	Projekti zhvillimor për fshatin Suk- qëndër	“Superstar – WB”	5,074,698	1 muaj	“Natasha Studio”
4	Rehabilitim i pjesshëm i Rrjetit të ujitjes, kanalet Suk - 1	“Shendelli”	14,892,882	45 ditë	“Angerba”
5	Ndërtim Rrethrotullim në anën Lindore në Unazën Roskovec	“Shendelli”	8,876,346	1 muaj	“Angerba”
6	Rikonstruksion i Rrugës Nacionale Ish-Reperti – Rruga Roskovec, Kurjan	“Hastoçi”	11,780,454	2 muaj	Angerba
7	Ndërtim K.U.Z Fshati Marinëz, zona Marinëz fushë, zona II	“ZZ Konstruksion”	23,883,111	2 muaj	Selas
8	Rikonstruksion i Rrugës kryesore Fshati Velmish, L 1627 ML (Rruga nr.4)	“Ajzberg” & “Stela 2000”	9,915,384	2 muaj	Angerba

9	Ndërtim stacion Pompimi =2ST Fshati Suk- 1	“Shëndelli”	11,091,991	2 muaj	“Palma Konstruksion”
10	Ndërtim K.U.Z Fshati Strum, zona II, Roskovec	“Glavenica”	15,718,903	2 muaj	Selas
11	Riparim dhe sistemim, Shkolla 9-vjeçare, Vlosh	Sark Shpk	1,803,396	40 ditë	Novatech studio
12	Loti 1: Rikonstruksion i rrugës Refat Çepele dhe rruga e lagjes nr.1	“Shkëlqim 07”	19,210,914	2 muaj	Angerba
13	Sistemim i Qendrës së fshatit Ngjeqar	“Shkëlqim 07”	14,115,048	2 muaj	Angerba
14	Rikonstruksion rruga kryesore fshati Mbërs	“Grand Konstruksion M”	15,034,200	2 muaj	Angerba
15	Mirëmbajtje e rrugëve të brendëshme, Njësia Administrative Kuman, Kurjan	“2 Z Konstruksion”	4,978,824	7 muaj	Angerba
16	Projekt Zhvillimor për Fshatin “Suk 2”	“Boshnjaku B” + “Pesë Vëllezërit” + “Aluera”	17,628,089	3 muaj	Novatech Studio
17	Mirëmbajtje rrugë të brendëshme, Njësia Administrative Kuman, Kurjan	“Beton EG Fier”	2,964,720	1 muaj	Angerba
18	Projekt zhvillimor i Qendrës Kuman	“Ajzberg” + “Klajger Konstruksion”	28,800,000	4 muaj	Angerba
19	Rikonstruksion i Rrugës Kolanjakët Roskovec	“B 93”	9,852,484	2 muaj	Angerba
20	Ndërtim Trotuari i Rrugës së fshatit Velmish	“Ajzberg” + “Sardo”	12,784,319	3 muaj	Angerba
21	Përmisim i kushteve të banimit për komuniteti Rom & Egjiptian.	“Piervis”	7,641,854	6 muaj	Palma konstruksion
22	Sistemim i qendrave të fshatrave të ndara në lote Loti 2: Lulishtja e Jagodinës	“Aluera”	2,884,704	1 muaj	Novatech Studio
23	Ndriçim i Rrugës Kuman – Roskovec	“Sark”	3,216,720	45 ditë	Palma Konstruksion
24	Sistemim asfaltim i Rrugës së Fshatit Kurjan	“Fusha”	143,835,891	9 muaj	Angerba
25	Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Marinëz-Jagodinë	“Shkëlqimi 07”	66,783,740	12 muaj	Selas

Kurse, për vitin 2018, kemi :

Kontratat dhe investimet për vitin 2018

Nr.	Emërtimi i kontratës	O E fitues	Vlera e kontratës	Afati i mbarimit	Mbikqyrësi i punimeve
1	Rikonstruksion i godinës 1-katëshe pranë Spitalit Roskovec	SARK	908,940	3 muaj	Natasha Myrtaj
2	Rikonstruksioni i stacioneve të pompave Jagodinë, Arapaj, Metush Hoxhenj	Aluera & Llazo	3,134,232	2 muaj	Angerba
3	Loti I Projekt Restaurimi Kisha e "Shën Kollit" në Kurjan	JOGI	4,473,186	8 muaj	HE&SK 11
4	Loti 2 : "Sistemim i terrenit të jashtëm të kishës së "Shën Kollit" në Kurjan, Roskovec	"VELLEZËRIT KUKA"	4,667,478	6 muaj	Palma Konstruksion
5	Rikualifikim urban rruga kryesore Suk 2 (vazhdim)	BOSHNJAKU.B	27,549,464	6 muaj	Angerba
6	Ndërtim sinjalistike në qytet – faza e pare	ZDRAVO	43,250,235	6 muaj	Angerba
7	Rikonstruksion i rrugës Rrethrotullimi "Vajza Myzeqare" – Marinëz – Faza 1	2 Z KONSTRUKSION	24,450,780	6 muaj	Leni- Ing
8	Rikonstruksion rruga "Gjergji Goga" dhe "Komunale"	SPARTAKU	13,972,296		Natasha Myrtaj
9	Rikonstruksion i fushës së futbollit, Vidhishtë	VELLEZËRIT KUKA	2,725,520	2 muaj	Natasha Myrtaj
10	Blerje materjale objekti "Ndërtim KUZ lagjia Shurdhenj, fshati Kuman"	VELLEZËRIT KUKA	6,464,106	Gjatë vitit	Selas
11	Blerje material objekti: "Ndërtim KUZ Roskovec" (të munguara), L= 1424 ml	MURATI D	4,313,070	Gjatë vitit	S'ka
12	Blerje materjale objekti: "Ndërtim KUZ Qendër Suk 2"	VELLEZËRIT KUKA	6,475,890	Gjatë vitit	Selas Shpk
13	KUZ Lagj tek ish- komuna Kuman – Faza III	VELLEZËRIT KUKA	7,060,152		Novatech Studio
14	Rikonstruksion i rrugës "Elmas Pelo" fshati Kuman	2 Z KONSTRUKSION	4,483,217	2 muaj	Angerba
15	Rikonstruksion i rrugës kryesore, fshati Mbërs , Loti II, L=895 ml	GRAND KONSTRUKSION	14,921,880	3 muaj	Arena MK
16	Asfaltimi i rrugëve të qytetit, Roskovec	SHKELQIMI 07	17,797,464	2 muaj	Angerba
17	Rehabilitim i ish-bllokut të S.M.T, Roskovec- Faza I"	AR & ED	14,941,560	3 muaj	Angerba
18	Rikonstruksion i rrugës Lagjia	GLAVENICA	10,829,952	3 muaj	Angerba

	Çobenjtë + Ndërtim trotuari në rrugën e Lagjes Kafaj, fshati Strum.				
19	Rikonstruksion i rrugës së Varrezave “Lagjia Shabanaj”	VELLEZËRIT KUKA	1,463,850	3 muaj	Studio Viki
20	Rikonstruksion Rruga e Varrezave , Fshati Strum, L=229 m	VELLEZËRIT KUKA	2,613,016		Selas
21	Rikonstruksion i rrugës “Gegallarët” + “Kumarakët”, fshati Kurjan	SHENDELLI	10,947,305	6 muaj	Natasha Myrtaj
22	Rikonstruksion i rrugës “Likallarët”, fshati Vlosh (vazhdim)	2Z KONSTRUKSION	6,404,832	3 muaj	Natasha Myrtaj
23	Rikonstruksion i rrugës Lagja Toska, fshati Suk, (Rruga Lime dhe Hyrkaj), L=1437 ml	2Z KONSTRUKSION	6,489,000	3 muaj	Engineering SHPK
24	Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, fshati Arapaj, L=290 ml	2Z KONSTRUKSION	1,119,600	3 muaj	Angerba
25	Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, fshati Vlosh, L=500 ml	2Z KONSTRUKSION	2,366,400	3 muaj	Angerba
26	Rikonstruksion rruga e varrezave, fshati Marinëz (asfaltim)	SHKELQIMI 07	6,252,480	6 muaj	Angerba
27	Rikonstruksion i rrugës së lagjes Kurtaj, fshati Ngjeqar – Faza I	GLAVENICA	17,470,080	6 muaj	Angerba
28	Asfaltim i rrugës kryesore të fshatit Velmish	DEHA 2010	9,847,800	6 muaj	Angerba
29	Rikonstruksion i rrugës së Beqallarëve, fshati Mbërs	ALUERA	1,545,239	6 muaj	Selas
30	Rikonstruksion i rrugës lagja Doganët, fshati Arapaj	SHKELQIMI 07	8,556,000	6 muaj	B-VAAL Engineerin
31	Rikonstruksion i rrugës së Xhokallarët, fshati Strum	2Z KONSTRUKSION	11,327,760	6 muaj	Ing. Ilmi Deraj
32	Rikonstruksion i rrugës së Varrezave, fshati Velmish	AR&ED	4,163,184	6 muaj	Studio Viki
33	Rikonstruksion i rrugës “Gogallarët”, L=890 ml + rruga e varrezave, L=280 ml, fshati Ngjeqar	ALUERA	6,728,208	6 muaj	Selas
34	Sistemim, Asfaltim i rrugës “Rrethrotullimi – Yzedin Hatillari”	2Z KONSTRUKSION	21,033,396	3 muaj	Angerba
35	Rikonstruksion i rrugës së lagjes Metushaj, fshati Suk 1, L=1074-Faza I	2Z KONSTRUKSION	17,538,840	6 muaj	Angerba
36	Rikonstruksion i rrugës Kuman-	BOSHNJAKU.B	37668,893	12 muaj	Natasha

	Luar – Vidhisht, Pr 1900-4110, L=2210 ml b= 4+2*0.5 m				Myrtaj
37	Rikonstruksion i rrugës “Shkolla 9-vjeçare – Demollarët”, fshati Vidhisht, L= 860 ml	VELLEZËRIT KUKA	5,404,188	6 muaj	Natasha Myrtaj
38	Sistemim, Asfaltim i rrugës së fshatit Jagodinë (vazhdim)	ALUERA	18,211,368	6 muaj	Arena MK
39	Kontrata shitesë për objektin: “Rikonstruksion i rrugës Lagjia Çobenjtë” + Ndërtim trotuari në rrugën e Lagjes Kafaj, fshati Strum	GLAVENICA	1,813,538	3 muaj	Angerba
40	Prishje objektesh ndërtimore “Transport dhe pastrim i inerteve nga prishjet, lirimi i sheshit blloku urban nr.2 Roskovec.	VELLEZËRIT KUKA	3,484,680	3 muaj	S’ka
41	blerje bazë materiale objekti: “Ndërtim trotuari” + ndriçim nga xhamia Suk 1- karburant Agaçj	SARK	3,892,910	Gjatë vitit	S’ka
42	Blerje material objekti: Rehabilitim i bllokut urban L.Braho (rruget Jonus Çepele, Dane Çepele, Mustafa Buzi)	2Z KONSTRUKSION	3,949,321	Gjatë vitit	S’ka
43	Përmirësimi i kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara	SHENDELLI	111,007,957	6 muaj	Natasha Myrtaj
44	Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare “Ajet Toska” Suk 2	“BOSHNJAKU B” & “SHENDELLI”	49,539,900	7 muaj	Angerba
45	Rehabilitim i ambienteve sportive + palestër shkolla “Alush Grepcka”, Roskovec	SENKA SHPK	50,599,244	4 muaj	Ballkan engineering
46	Ndërtim i ujësjellësit për fshatrat Marinëz- Jagodinë	SHKELQIMI 07	79,280,488	12 muaj	Selas Shpk
47	Ndërtimi i godinës 3 katëshe për strehim social	AURORA KONSTRUKSION	22,375,302	8 muaj	Arena MK
48	Mbrojtje nga lumi Seman e stacionit të pompave Hoxhenj Suk 1	BO. Aluera& Llazo	2,973,566	15 ditë	Angerba
49	Riparim i shkarjes së rrugës e fshatit Luar	5 VELLEZËRIT	4,767,360	15 ditë	Angerba
50	Sistemim, asfaltim i rrugës Suk 1- Arapaj- Samaticë	FUSHA		6 muaj	Angerba
51	Ndërtimi i qendrës Rinore	2Z KONSTRUKS.		6 muaj	Arena MK
52	Rikonstruksion i fushës së futbollit Vidhishtë	VELLEZËRIT KUKA	2,725,520	2 muaj	Natasha Myrtaj

Nga viti 2018 e në vazhdim (përgjatë vitit 2019) janë realizuar këto investime :

Nr.	Emërtimi i kontratës	Operatori Ekonomik fitues	Vlera e kontratës	Afati i fillimit të kontratës	Afati i kontratës	Mbikqyrësi i punimeve
1.	Rikualifikimi urban, rruga kryesore SUK 2 (vazhdim)	“BOSHNJAKU B”	27.549.464	19.06.2018	6 muaj	“ANGERBA”
2.	Ndërtim sinjalistike në qytet- faza e parë	“ZDRAVO” shpk	43.250.235	02.07.2018	6 muaj	“ANGERBA”
3.	Rikonstruksion i rrugës Rrethrotullimi “Vajza Myzeqare” – Marinëz- faza 1	“2 Z Konstruksion” Shpk	24.450.780	17.10.2018	6 muaj	“LENI-ING”
4.	Blerje material objekti: “Ndërtim KUZ Qendër Suk 2”	“VËLLEZËRIT KUKA” Shpk	6.475.890	20.08.2018	30.06.2019	
5.	Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Jagodinë (vazhdim)	“ALUERA” Shpk	18.211.368	09.12.2018	2 muaj	“NATASHA MYRTAJ”
6.	Blerje baze materiale objekti: “Rehabilitim i bllokut urban L. Braho (Rrugët Jonus Çepele, Dane Çepele, Mustafa Buzi) (blerje material) Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ajet Toska”, Suk2	“2 Z Konstruksion” Shpk “BOSHNJAKU.B” Shpk “BOSHNJAKU.B” Shpk & “SHENDELLI” Shpk	3.949.321	10.08.2018 07.09.2018	31.12.2019 7 muaj	 “ANGERBA”
7.	Rehabilitim i ambjenteve sportive + palestër shkolla “Alush Grepcka”	“SENKA” Shpk	50.599.244	21.09.2018	4 muaj	“BALLKAN ENERGJI”
8.	Ndërtim i godinës 3 katëshe për strehimin social	“AURORA” Shpk	22.375.302	14.02.2019	8 muaj	“NATASHA MYRTAJ”

Ndërsa, për vitin 2019 janë prokuruar fonde publike, si dhe janë lidhur një seri kontrata të ndara si më poshtë :

1. Kontratë blerje material ndërtimi 3(tre) kontrata
2. Kontratë blerje karburant, vaj, dhe graso 4 (katër) kontrata

3. Kontratë pjesë këmbimi 3 (tre) kontrata
4. Kontratë për mbikqyrje punimesh 10 (dhjetë) kontrata
5. Kontratë për blerje Tubo betoni + tubo të brenjëzuara 1 (një) kontratë
6. Kontratë për punime ndërtimi, rrugë rikonstruksione e tjerë 29 (njëzet e nëntë) kontrata.

Pjesa më e madhe e kontratave janë realizuar (nga 48 të tilla, kemi realizim të tyre për 39 kontrata, ose në masën 81.2 %).

Njëkohësisht pjesa më e madhe e kontratave, punime ndërtimi, rikonstruksion rruge, rikonstruksion objektesh, janë pajisur me leje ndërtimi dhe me deklaratë paraprake sipas ligjit.

Bashkangjitur janë tabelat e detajuara të kontratave sipas objekteve.

Kontratat dhe investimet për vitin 2019

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik fitues	Data e lidhjes së kontratës	Mbikqyrësi punimeve
1.	Asfaltim i rrugës “Xhemal Lamo”, fshati Kuman, b=4m+2*0.5m kunetë	3.117.020	VËLLEZËRIT KUKA Shpk	08.04.2019	“Angerba” Shpk
2.	Blerje materialesh për investime që do të kryhen nga sektori i investimeve	6.337.582	VËLLEZËRIT KUKA Shpk	11.03.2019	S’ka
3.	Blerje materialesh për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj.	8.823.780	SARK Shpk	26.03.2019	S’ka
4.	Blerje materialesh për rrugë e trotuare dhe për sektorin e dekorit gjatë vitit	3.046.450	SARK Shpk	11.03.2019	S’ka
5.	Karburant, vaj dhe graso	5.362.817	“ÇEPELE”shpk	20.03.2019	S’ka
6.	Karburant, vaj dhe graso	3.725.705	A G A-1 Shpk	26.03.2019	S’ka
7.	Karburant, vaj dhe graso	2.664.382.	“ÇEPELE” Shpk	20.03.2019	S’ka
8.	Karburant, vaj dhe graso për mjetet e bordit të kullimit dhe zjarrëfikse	5.021.555	“ÇEPELE” Shpk	06.05.2019	S’ka
9.	Sistemimi i qendrës së fshatit Ngjeqar, L=1141 ml	11.24.510	“SHKËLQIMI 07” Shpk	01.03.2019	S’ka
10.	Sistemim i qendrës së fshatit Ngjeqar, L=1141ml. kontrata shtesë	1.200.200	“SHKËLQIMI 07” Shpk	13.09.2019	“SELAS” Shpk
11.	Mbikqyrje punimesh për kontratë punime shtesë “Sistemim i qendrës së fshatit Ngjeqar, L=1141 ml	20.264	“SELAS” Shpk		
12.	Mbikqyrje punimesh për “				

	Rehabilitim/ përforcim banesash ekzistuese	205.000	“LENI-ING” Shpk		
13.	Mbikqyrje punimesh për “Ndërtim i dy shatërvanëve”	29.028	“ANGERBA” Shpk		
14.	Mbikqyrje punimesh për objekte	97.785	“NET-GROUP“ Shpk		
15.	Ndërtim i dy shatërvanëve	1.502.280	“SARK” Shpk	01.11.2019	“Angerba” Shpk
16.	Ndërtim trotuari+ndriçim i rrugës “Faik Kapo”, Roskovec, L=220ml, b=5m+1.5m trotuar	1.438.496	“VËLLEZËRIT KUKA”	08.04.2019	“Angerba” Shpk
17.	Ndërtim Ure Auto Hd=3m, H=2m, L=5m, mbi kanal in kullues K-34, fshati Suk 2	633.000	“ASI-2A CO”		“NET GOUP”
18.	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri dhe mirëmbajtje mjetesh	842.833	“ÇEPELE”	15.05.2019	
19.	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri dhe mirëmbajtje mjetesh	1.865.100	“ÇEPELE”	15.05.2019	
20.	Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjetesh	1.614.800	“MAG”	15.05.2019	
21.	Rehabilitim i bllokut të ish- SMT-së Roskovec, rruga “Fotografi” N.3, (L=152ml)	5.041.405	“AR&ED”	24.04.2019	
22.	Rehabilitim i bllokut të ish SMT-së Roskovec, rruga “Gramoz Çepele” nr .8, (L=100ml)	5.041.405	“AR&ED”	24.04.2019	
23.	Rehabilitim/përforcim banesash ekzistuese	9.086.777	“SHKËLQIMI 07”	16.10.2019	“LENI- ING” Shpk
24.	Rehabilitim i qendrës së fshatit Strum	10.589.374	“ALUERA”	20.03.2019	“SELAS” Shpk
25.	Rehabilitim i ujëmbledhësit Kurjan	19.979.324	“AD-STAR”	31.07.2019	“ANGERA “ Shpk
26.	Rehabilitim i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut	45.094.345	“2 Z Konstruksion”	25.07.2019	“SELAS” Shpk
27.	Rikonstruksion godine dhe ndërtim palestere gjimnazi “Adem Vrapit”	82.809.833	“SENKA”	10.07.2019	“LENI=ING ” Shpk
28.	Rikonstruksion i rrugës “Gjonas-Stan” fshati Ngjeqar	4.478.236	“AR&AD”	25.07.2019	“NET GOUP”
29.	Rikonstruksion i rrugës “Lagjia Cerven” fshati Kurjan	1.224.100	“VËLLEZËRIT KUKA”	08.04.2019	“ANGERA” Shpk
30.	Rikonstruksion i rrugës kryesore				“ANGERA”

	“Lagjia Agaçaj”, fshati Suk 1 (asfaltim)	6.721.646	“JOGI”	26.03.2019	Shpk
31.	Rikonstruksion i rrugës “Lagjia Begallerët + Muskallaret”, fshati Strum, L=1960 ml, b=4m+2*0.5m bankine	7.303.600	BOSHNJAKU. B	11.03.2019	“ANGERA” Shpk
32.	Rikonstruksion i rrugës pas shkollës 9-vjeçare, fshati Vlosh.	4.394.800	“2Z KONSTRUKS.”	18.03.2019	“ANGERA” Shpk
33.	Rikonstruksion i rrugës së kishës, fshati Marinëz	6.683.930	“HARMONIA”	26.03.2019	“ANGERA” Shpk
34.	Rikonstruksion i rrugës së Kukallarëve, fshati Kurjan- rërë bituminoze	7.917.500	“SHENDELLI”	05.03.2019	“ANGERA” Shpk
35.	Rikonstruksion i rrugës Shkolla 9-vjeçare Kërranjakët	6.074.926	“BOSHNJAKU.B”	11.03.2019	“ANGERA” Shpk
36.	Rikonstruksion i rrugës “Syrri Balla”, fshati Kuman, L=260 ml, b=4m.	1.239.100	“VËLLEZRIT KUKA”	24.06.2019	“NET GOUP”
37.	Rikonstruksion i rrugës (Unazalagjia e Dushkut)	3.742.280	“SHENDELLI”	05.04.2019	“ANGERA” Shpk
38.	Rikonstruksion rruga “Lagjia e Naftës”, kodër, L=750 m	8.180.260	“GRAND Konstruksion M”	07.03.2019	“ANGERA” Shpk
39.	Rikualifikim urban i bllokut, L. Agaçaj, (ish baxhos), Roskovec	12.487.097	“ZDRAVO”	24.04.2019	“SELAS” Shpk
40.	Rikualifikim urban Lagjia e Spitalit, L=854ml, b=4m asfalt +2*0.5m kunetë +1.5m tortuar, faza I	13.647.416	“COMPANY RIVIERA 2008”	15.04.2019	“SELAS” Shpk
41.	Rikualifikim urban në fshatin Marinëz (Rruga Llambi Marku)	10.029.873	“GLAVENICA”	01.03.2019	“SELAS” Shpk
42.	Sistemim - Asfaltim i rrugës nr. 3, fshati Velmish, L = vet672ml + rikonstruksion çezmë publike- Faza I, b=3.5m +0.5m kunetë+1.25m tortuar	8.250.385	“Boshnjaku B”	26.04.2019	“ANGERA” Shpk
43.	Spostim i linjës elektrike nga Vajza Myzeqare Marinëz	405.000	“AA & P”		
44.	Supervision të objektit: Rehabilitim i pesë kanaleve në zonën e Sukut	885.797	“SELAS” Shpk	01.08.2019	

45.	Supervizion të objektit: Rehabilitim i ujëmbledhësit Kurjan	538.866	“ANGERA” Shpk		
46.	Supervizion të objektit : “Rikonstruksion godine dhe ndërtim palestere gjimnazi ”Adem Vrapit””	1.024.240	“LENI-ING” Shpk	16.07.2019	
47.	Supervizion të objekteve në procedurë	733.045	“ANGERA” Shpk	08.04.2019	
		670.000	“SELAS” Shpk	20.03.2019	
		400.840	“NOVATECH STUDIO”	11.03.2019	
48.	Tabo betoni + tabo të brenjëzuara	2.698.100	BAÇI-EL 2003	11.03.2019	

B. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Emergjencat Civile

Emergjencat Civile

Në realizimin e misionit të vet, kjo strukturë ka hartuar planin e masave, ku ndër më kryesore janë:

1. Rreziku nga përmbytjet e mundëshme.
2. Rreziku nga zjarrvënja për periudhën e verës.
3. Ngritja e komisionit vendor për emergjencat civile në Bashki.

Me ngritjen e Komisionit Vendor të Emergjencave Civile pranë Bashkinë Roskovec për vitin 2019, përgjatë aktivitetit të tij (6 mujori i I-rë), ka evidentuar edhe raste të rënies së zjarreve, të dokumentuara si më poshtë :

- Ngjeqar, “Lagjia Stan”, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (dt.05.02.2019)
- Luar, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (08.03.2019)
- Roskovec, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (25.03.2019)
- Kuman, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (09.06.2019)
- Roskovec, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (20.06.2019)
- Roskovec, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (22.06.2019)
- Roskovec, ka pasur nevojë për mjete zjarrëfikse dhe ka qenë e pranishme (04.07.2019)

Ka pasur dhe raste të tjera por nuk ka qenë e nevojshme prania e mjeteve zjarrfikëse, pasi është bërë shuarja e zjarrit në mënyrë vullnetare.

Gjatë 6-mujorit të dytë në Sektorin e Emergjencave Civile dhe në bashkëpunim me Sektorin e Zjarrëfikses janë evidentuar disa raste të rënies së zjarreve, konkretisht në muajt:

- Korrik – ka pasur 4 (katër) raste të rënies së zjarrit.
- Gusht – ka pasur 6 (gjashtë) raste të rënies së zjarrit.
- Shtator – Ka pasur 4 (katër) raste të rënies së zjarrit.
- Shtator ka qenë edhe tërmeti i rënë në datë 21.09.2019.

Pas daljes së Urdhërit të Kryetares për ngritjen e Komisionit për verifikimin e të gjitha ankesave të ardhura nga qytetarë të ndryshëm të komunitetit (për dëmtimet nga tërmeti), ky komision i ka marrë në konsideratë këto kërkesë-ankesa, dhe konkretisht janë pranuar 8 (tetë) ankesa, të cilat janë verifikuar dhe për çdo rast, u janë kthyer përgjigjet dhe zgjidhjet përkatëse. Për disa prej tyre, dëmtimet në banesat e verifikuara nuk kanë ardhur si pasojë e tërmetit por si rezultat i amortizimit të banesave për shkak të vjetërsisë së tyre. Për periudhën Tetor – Dhjetor, janë evidentuar raste të rënies së zjarreve, dhe si të tilla do të kemi :

- Tetor – Kemi pasur 4 (katër) raste të rënies së zjarrit.
- Nëntor – Ke pasur 3 (tre) raste të rënies së zjarrit.
- Në muajt Nëntor ka pasur edhe tërmetin e rënë në datë 26.11.2019.

Gjatë kësaj periudhe, konkretisht janë paraqitur 39 (tridhjetë e nëntë) ankesa, të cilat pas verifikimit të kryer i janë kthyer përgjigje për problematikat e ngritura.

Po kështu, gjatë kësaj periudhe ka pasur dhe kërkesa të ndryshme nga qytetarë, gjithashtu dhe shkresa dhe korrespondenca nga institucione të ndryshme, të cilave ju janë kthyer përgjigje në varësi të problemeve që trajtojnë, por dhe në zbatim të ligjit. Gjatë vitit 2019 janë bërë verifikimet e rasteve të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 21 shtatorit dhe 26 nëntorit.

Në zbatim të Urdhërit nr. 86, datë 26.11.2019 të Kryetares të Bashkisë, dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, paragrafi III, mbështetur në shkronjën b, pika I “Procedurat e vlerësimit të dëmeve”, paragrafi III, Komisioni i konstatimit verifikon mbas ankesave të bëra për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, (dëmtimet janë si pasojë e amortizimeve si dhe ndikimet nga lëkundja e tërmetit), dhe nga ku rezulton :

1. Shkolla 9-vjeçare Luar, gjatë verifikimit ka rezultuar se ka dy plasaritje në tavanë. Kjo ka ardhur si rezultat i amortizimit të ndërtesës si dhe i lëkundjeve të shkaktuara nga tërmeti.
2. Shkolla 9-vjeçare Vlosh, gjatë verifikimit u konstatua se ka plasaritje tërthore në dyer dhe në dritare, ka plasaritje të tavanit dhe plasaritje vertikale të murit ku fuga midis tullave është e madhe ka çarje të tortuarit në pjesën e pasme të shkollës. Kjo ka ardhur si rezultat i punimeve të gërmimit në anën lindore të shkollës. Rekomandojmë ndërtimin e një muri mbajtës si dhe riparimin e fugave në godinë.
3. Gabriel Ester, banor i Fshatit Kuman, nga verifikimi i bërë në banesën e tij rezultoj se banesa ka plasaritje horizontale të mureve, trarëve dhe të themeleve. kjo ka ardhur si pasojë dhe rezultat i lëkundjeve të mëparëshme dhe të fundit nga tërmeti.
4. Andon Goga, banor i qytetit të Roskovecit, nga verifikimi u konstatua se në pallatin ku banon nuk ka dëmtime nga tërmeti, nga ku rezultoi se soleta kishte nevojë për hidroizolim dhe ishte e mbingarkuar nga depozitat e ujit.
5. Besnik Goga, banor i Fshatit Ngjeqar, gjatë verifikimit u konstatua se ka plasaritje të mureve , rënie suvatimeve, banesa është e amortizuar. Nga verifikimet arrijmë në konkluzionin se këto dëmtime nuk kanë ardhur si rezultat i tërmetit.

25. Isa Hoxha, ka një banesë me katër dhoma e ndërtuar me blloqe, me çati vëndi, është një banesë e amortizuar, ka një çarje vertikale dhe horizontale dhe rënie suvaje të tavaneve të cilat janë shkaktuar nga lëkundjet e fundit, dhe në përfundim është konstatuar si e pabanueshme.

26. Tomorr Plaka, ka një banesë dy katëshe me katër dhoma e me solet, e cila rezultoi se ka plasaritje të lehta.

27. Rushan Plaka, banon në një shtëpi një katëshe me solet, është një shtëpi e re ku janë konstatuar plasaritje të trarëve në ballkone.

28. Agron Prifti, banon në një shtëpi të shkatërruar, si pasojë e amortizimit janë dëmtuar vetëm dy dhoma ku dhe është verifikuar si banesë e pabanushme.

29. Dashnor dhe Mysaret Sateri, banojnë në një shtëpi të vjetër me gur të amortizuar, ku ka plasaritje muresh dhe rënie tavanesh.

30. Shkolla 9-vjeçare "Rexhep Kothere" Kuman, ka plasaritje horizontale ndërmjet murit dhe soletës, thyerje xhamash, ku ishin dëmtuar 3 (tre) dritare nga një kanat dhe një dritare komplet.

31. Laimen Hazizi, nga verifikimet e bëra rezultoi se banesa nuk ka problem nga tërmeti, shtëpia është e vjetër por e banueshme.

32. Baki Hyseni, dëmtimi i banesës ka ardhur si pasojë e vjetërsisë së ndërtimit dhe ndërhyrjes që ka bërë qytetari për shtesë banesë.

33. Sofjan Toro, ka një shtëpi të vjetër dhe të amortizuar nga vjetërsia e ndërtimit, dëmtimi i shtëpisë evidentohet nga rënia e çatisë, por jo si pasojë e tërmetit.

34. Ardjan Doksani, banon në Fshatin Kurjan, rezultoi nga verifikimet se nuk ka dëmtime.

35. Belul Zeqiri, banon në Fshatin Luar, rezultoi nga verifikimet se nuk ka dëmtime.

36. Ylli Hatia, banon në Fshatin Suk 1, rezultoi nga verifikimet se nuk ka dëmtime.

Në përfundim të këtij auditimi, duke vlerësuar në tëresi (mbi bazën e kqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion), për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, **konkludojmë** edhe që :

- Vlerësohet roli i drejtimit dhe bashkërendimi i punës me vartësit, por edhe me strukturat e tjera për hartimin e politikave dhe strategjive për përmirësimin e shërbimeve që ofrohet nga kjo drejtori ;

- Vlerësohet frekuenca e shpejtë e përgjigjeve të adresuara për Institucionet sipërore dhe Titullarin, por sidomos korrespondenca me komunitetin banues brenda territorit të Bashkisë Roskovec (për të gjitha problematikat që trajtohen në kërkesë - ankesat e tyre), etj

V. Plan Veprimi.

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", neni 21, pika 7, të konkluzioneve të auditimit të plotë me bazë sistemi të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Roskovec për periudhën nga 01.01.2017 deri 31.12.2019, grupi i punës së auditëve

Rekomandon :

1. Të synohet që nëpërmjet menaxhimit, mbikqyrjes, organizimit dhe bashkërendimit të punës të realizohet përmbushja e detyrave të ngarkuara, por dhe respektimi i afateve të dorëzimit të

punimeve për objekte të ndryshme, për të siguruar nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit brenda juridiksionit të Bashkisë Roskovec.

2. Të synohet që hartimi dhe përgatitja e analizave, raporteve dhe bërja e propozimeve për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e punës nga kjo Drejtori, të shërbejë për realizimin e objektivave të përcaktuara në kuadër të implementimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec.

3. Të synohet që në hartimin e projekteve të ndryshme dhe realizimin tyre, të arrihet përmirësimi i cilësisë së shërbimit, përshtatja e aksesueshmërisë së tyre me jetesën e komunitetit.

4. Të synohet në rritjen e efektivitetit të punës së personelit punonjës, për shqyrtimin e kërkesave të komunitetit për realizimin dhe kryerjen e punimeve të ndryshme, që do të siguronin miratimin dhe plotësimin e nevojave të paraqitura në këto kërkesa.

5. Të vazhdojë bashkëpunimi me strukturat e tjera të Bashkisë Roskovec dhe me Njësitë Administrative në varësi të saj, për hartimin e politikave dhe strategjive për përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit

6. Të vazhdojë ndjekja dhe kontrolli i punës që realizohet nga Sektorët vartës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për ato detyra të deleguara që kanë të bëjnë me çështje që drejtohen për trajtim dhe zgjidhje, për të arritur në dhënien e zgjidhjeve teknike, ligjore dhe administrative brenda afateve të përcaktuara me ligj, etj.

Për sa më sipër, hartohet ky Projekt Raport Auditimi në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje i lihet Drejtorisë së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Roskovec, dhe mbas nënshkrimit si më poshtë, 1 (një) kopje i dorëzohet grupit të auditimit.

D/DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Arben DUKAJ

A u d i t u e s i t

Gilda ZYKA

Eltona ÇEPELE

Gëzim HABILI